



**REPUBLIKA E KOSOVES**  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
OSNOVNI SUD PRISTINA - BASIC COURT OF PRISTINA

---

**AD/GJTHPR/21/24**

Kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Albina Shabani Rama, ka shqyrtuar ankesën e ushtruar nga B.C ndaj gjyqtarit S.S, për të vendosur për çështje disiplinore, duke vepruar në mbështetje të nenit 9, paragrafi 6 të Ligjit Nr.06/L-057 Për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe nenit 7, paragrafi 1 dhe 3 të Rregullores Nr.05/2019 Për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, me datë 09.10.2024 nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e ushtruar nga B.C ndaj gjyqtarit S.S për shkak se nuk ka bazë të arsyeshme për inicim të procedurës disiplinore.

**A r s y e t i m**

Parashtruesi i ankesës B.C me datë 05.08.2024 ka paraqitur ankesë disiplinore ndaj gjyqtarit S.S me pretendime për shkelje disiplinore, ankesë kjo e drejtuar në Këshillin Gjyqësor të Kosovës. Me datë 12.09.2024 ankesa është përcjellë në Gjykatën Themelore në Prishtinë, si organ kompetent për shqyrtimin e të njëjtës.

Parashtruesi i ankesës në shkresën e tij ka deklaruar se nuk ka marrë asnjë thirrje nga ana e gjyqtarit S.S në lidhje me seancë gjyqësore në rastin P.nr.405/22, përveç kur me datën 12.07.2024 ka ardhur policia dhe i kanë lëndë një letër që të lajmërohet në gjykatës. Sipas tij ai nuk e ka pranuar këtë njoftim por bashkëshortja e tij e cila edhe e ka njoftuar policinë se asnjëherë nuk ka pranuar ftesë nga gjykata në lidhje me këtë çështje. Tutje ka deklaruar se me datë 15.07.2024 në orën 09:00 ka qenë në gjykatë te gjyqtari i çështjes ku e ka njoftuar për pranimin e njoftimit nga policia. Pas kësaj, sipas tij gjyqtari ka lëshuar urdhër arrest, ku me datën 16.07.2024 ju është drejtuar me shkresë por urdhër arrestin e ka lënë në fuqi. Tutje ka deklaruar se me datën 02.08.2024 ka qenë në stacionin policor 92 për të marrë një letër tjetër që sipas tij ka qenë ftesë për gjykatë. Po ashtu, i njëjti ka deklaruar se ka qenë prezent kur zyrtari policor e ka thirrë në telefon gjyqtarin S.S në lidhje me prezencën et ë pandehurit B.C në stacion policor, ku sipas tij e ka dëgjuar gjyqtarin që i ka thënë zyrtarit policor të lirohet i pandehuri sepse pasdite do të bëjë tërheqjen e urdhër arrestit. Sipas tij është maltretuar nga policia përreth dy orë për faj të gjyqtarit dhe prokurorit.

Gjyqtari i çështjes në lidhje me ankesën e parashtruar ka deklaruar se në lidhje me këtë çështje gjyqësore ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestar me datë 11.03.2024 me që rast e ka ftuar me ftesë të rregullt edhe të pandehurin B.C, por që nuk është kthyer fletë kthesa nëse i njëjti e ka

pranuar a po jo të njëjtën. Pas kësaj e kanë telefonuar të pandehurin edhe në numrin e tij të telefonit por që i njëjti është përgjigjur se nuk mund të vijë. Në lidhje me këtë, gjyqtari i çështjes ka deklaruar se me datë 28.06.2024 ka lëshuar urdhëresën për sjellje me detyrim ku policia janë përgjigjur se të pandehurin nuk e kanë gjetur në shtëpi. Pas kësaj përgjigje, gjykata ka lëshuar urdhër arrestin.

Tutje gjyqtari ka deklaruar se i pandehuri B.C papritur ka ardhur në zyre dhe ka deklaruar se nuk do të rri për seancë dhe se sipas tij nuk është marrë asnjëherë në pyetje në prokurori. Sipas gjyqtarit të çështjes, me datë 16.07.2024 e pranon një kërkesë nga ana e të pandehurit ku deklarohet se nëse prokurori i cili e ka ngrit aktakuzën është në seancë, atëherë i njëjti nuk do të marrë pjesë.

Ndër të tjera, gjyqtari ka deklaruar se pasi që ka konstatuar se i njëjti nuk është marrë në pyetje asnjëherë në prokurori, me datë 17.07.2024 i ka dërguar prokurorisë kërkesën për plotësim të aktakuzës dhe meqenëse prokuroria nuk ka kthyer përgjigje, gjykata e ka hedhur aktakuzën me datën 05.08.2024. Me datën 01.08.2024 policia e kontakton gjyqtarin duke e njoftuar se në stacion është B.C, ku sipas gjyqtarit i ka njoftuar policinë që mos ta sjellin të njëjtin në gjykatë dhe ta lirojnë pasi që sot e ka kthyer aktakuzën në plotësim dhe ka bërë tërheqjen e urdhër arrestit ndaj të njëjtit.

Në fund, gjyqtari ka deklaruar se në çdo rast kur i pandehuri nuk i përgjigjet ftesës gjykata vepron sipas dispozitave ligjore për sigurimin e prezencës së të njëjtit, ashtu siç edhe vepron në çdo rast kur prokuroria nuk i përmbush obligimet e veta ligjore.

Autoriteti kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, deklarimit të gjyqtarit dhe pretendimeve të parashtruesit të ankesës, ka vlerësuar se nuk ka dyshim të arsyeshëm për inicim të procedurës disiplinore ndaj gjyqtarit S.S.

Në referim të pretendimeve të parashtruesit të ankesës si dhe bazuar në Ligjin për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve, për Autoritetin Kompetent ishte e rëndësishme gjetja e shkeljeve të cilat parashihen me nenin 5 të Ligjit Nr. 06/L – 057, të cilat janë: dënimi për një vepër penale; shkelja e ligjit, ose shkelja e detyrave të tij zyrtare si gjyqtar.

Sa i përket pretendimit se i pandehuri nuk është ftuar në mënyrë të rregullt dhe rrjedhimisht nuk ka pranuar asnjëherë ftesë nga gjykata, nga shkresat e lëndës është konstatuar se i njëjti është ftuar me ftesë të rregullt gjë e cila është provuar me librin e evidencës së ekspedimeve, por që nuk është kthyer fletë kthesa nga ana e Postës së Kosovës. Duke qenë në këto rrethana, i njëjti është ftuar përmes telefonit në numrin i cili gjendet në shkresat e lëndës, e për çka është konstatuar në procesverbalin gjyqësor të datës 11.06.2024 se i pandehuri në këtë telefonatë ka deklaruar se nuk mund të vijë duke mos paraqitur arsye.

Në referim të pretendimeve të parashtruesit të ankesës, Kryetarja e Gjykatës ka gjetur se në rastin konkret gjyqtari i çështjes ka ndërmarrë të gjitha veprimet e parapara ligjore për sigurimin e prezencës së të pandehurit në seancë gjyqësore, masa këto të parapara me nenin 171 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Në bazë të shkresave të lëndës, shihet se pas shqyrtimit të aktakuzës dhe kërkesës me shkrim të te pandehurit të datës 16.07.2024, gjyqtari i çështjes ka konstatuar se në aktakuzë nuk është plotësuar detyrimi i marrjes në pyetje të te pandehurit as në polici dhe as në Prokurori, andaj me datë 17.07.2024 ka kërkuar nga Prokuroria Themelore plotësimin e aktakuzës. Me kthimin e aktakuzës në plotësim, gjykata me datë 01.08.2024 ka tërhequr urdhër arrestin për te pandehurin B.C, me arsyetimin se meqenëse aktakuza është kthyer në plotësim pushojnë shkaqet për urdhër arrest.

Meqenëse nuk ka pranuar një përgjigje nga Prokuroria Themelore brenda afatit të paraparë ligjor në lidhje me plotësimin e aktakuzës, gjykata me datë 05.08.2024 ka nxjerrë aktvendim për hedhje të aktakuzës.

Kryetarja e Gjykatës ka vlerësuar se veprimet e gjyqtarit gjatë trajtimit të lëndës gjyqësore, janë veprime të ndërmarra në kuadër të autorizimeve të tij si gjyqtar dhe si te tilla nuk mund të paraqiten si pretendime për shkelje disiplinore.

Autoriteti Kompetent njofton parashtruesin e ankesës se pretendimet e parashtruara nga i njëjti mund të jenë pretendime për shkelje procedurale të cilat mund të atakohen me ankesë në Gjykatën e Apelit, pasi të merret vendimi përfundimtar në lidhje me çështjen gjyqësore. Gjykata e Apelit si shkallë e dytë është kompetente që të shqyrtoj sipas detyrës zyrtare nëse ekzistojnë shkelje të dispozitave të procedurës penale sipas nenit 384 paragrafit 1 të këtij Kodi ose nëse është shkelur ligji penal në dëm të te akuzuarit.

Nga të lartcekurat, Autoriteti Kompetent i Gjykatës Themelore në Prishtinë lidhur me ankesën e ushtruar, bazuar në të dhënat e përshkruara më lartë, vlerësoj se nuk ka bazë të arsyeshme të besoj se gjyqtari ka kryer shkelje disiplinore, për t'i parashtruar Këshillit Gjyqësor të Kosovës kërkesë për fillimin e hetimeve disiplinore.

Nga të cekurat më lartë, në bazë të nenit 7, paragrafi 3, të rregullores Nr.05/2019, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

## GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

AD/GJTHPR/21/24, me datë 09.10.2024

Albina Shabani Rama

---

Kryetare e Gjykatës Themelore në Prishtinë